

PROJEKT

MARRËVESHJE E BASHKIMIT TË SHOQËRIVE NËPËRMJET PËRTHITHJES

SHOQËRIA "ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS "SH.P.K.

Forma Juridike: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Selia: Njesia Bashkiake Nr.6, Rruga Fabrika e Qelqit, Zona Kadastrale 8230, Nr.Pas.2/63, Tiranë.
Kapitali Themeltare: 465,000,000.00 Leke
Pjese e kapitalit: 100%
ORTAKET: Concord Investment Sh.p.k 39.78%
Z. Artan Dulaku - zoteron 21.68 % te kapitalit
Z. Adrian Dulaku - zoteron 15.66 % te kapitalit
Z. Genci Dulaku - zoteron 15.35 % te kapitalit
Z. Benjamin Feinberg - zoteron 7,53 % te kapitalit
NIPT K62115018I
Administrator: Znj. Juliana Guri

SHOQËRIA PËRTHITHËSE

DHE

SHOQËRIA "TV KABLLOR SHIJAKU "SH.P.K.

Forma Juridike: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Selia: Lagja Popullore, Shijak, Durrës
Kapitali Themeltare: 3,600,000.00 LEKE
Pjese e kapitalit: 100%
Ortaku: Albanian Satellite Communications Sh.p.k
NIPT L31902508J
Administrator: Z.Shkelqim Berhami

SHOQËRIA E PËRTHITHUR

Bien dakort për sa vijon:

1. OBJEKTI I MARRËVESHJES

Objekt i kësaj Marrëveshje është bashkimi nëpërmjet përthithjes i shoqërisë së Perthithur “BLETA ” sh.p.k nga shoqëria Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” shpk.

Në këtë operacion bashkimi shoqëria “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” shpk do të jetë shoqëria përthithëse ndërsa shoqëria “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k do të jetë shoqëria e përthithur.

Objekti i veprimtarisë për shoqërinë Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” shpk është:

Aktivitet i shërbimit në fushën e telekomunikacionit dhe komunikimeve elektronike, transmetimit satelitor, transmetimit të të dhënave, figurë, video, kërkime, konsultime, projekte, organizim, shpërndarja e produkteve të teknologjisë së lartë, shitja dhe zbatimi i studimeve të ndryshme, shërbimi publik i telefonisë tokësore fiksetransmetimi i të dhënave etj; kryerja e veprimeve financiare dhe tregtare që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi me aktivitetin e saj, duke përfshirë këtu edhe zgjerimin e aktivitetit, krijimin e shoqërive të reja, si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të reja brenda dhe jashtë vendit. Të marrë përsipër transaksione në lidhje me pasuri të luajtshme dhe ose të paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës ose hipotekor i cili mund të konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm nga administratori, në mënyrë që të përmbushet objekti i aktivitetit të shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos tejkalojnë përcaktimet e sipërcituara; dhënia e linjave me qera; të kryejë aktivitete reklamuese; të zotërojë drejtpërdrejt ose tërthorazi, interese në shoqëri të tjera të cilat kanë qëllime të ngjashme me ato të shoqërisë, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Kryerja e aktiviteteve financiare jo-bankare, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga autoritetet rregullatore kompetente, të cilat përfshijnë por nuk kufizohen vetëm tek arkëtimi dhe transferimi i parave. Kryerja e aktivitetit import – eksport në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga autoritetet rregullatore kompetente, shitjen dhe distribucionin e pajisjeve të telekomunikacionit si dhe të cdo lloj produkti tjetër. Kryerja e aktivitetit të transmetimeve dhe ritransmetimeve audio dhe audiovizive nëpërmjet sistemeve të telekomunikacionit për transmetimet dhe ritransmetimet audio dhe audiovizive të cdo lloji dhe në cdo lloj rrjeti si dhe shitjen e produkteve apo shërbimeve audio dhe video në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga autoritetet rregullatore kompetente.

Objekti i veprimtarisë për shoqërinë e Perthithur “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k është:

Veprimtari televizioni kabllor.

Të dyja shoqëritë sa më lart, pra Shoqëria “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k dhe shoqëria “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k hartojnë këtë projekt marrëveshje nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjor, bazuar specifikisht në Nenet 215, 216, 225 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 dhe ndryshimet përkatëse “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Duke qenë se Shoqëria Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k dhe shoqëria që do të përthithet “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k, kanë ortakë të përbashkët, ky bashkim me përthithje do të realizohet bazuar në këtë Marrëveshje.

2. MOTIVET DHE QËLLIMI I BASHKIMIT

Bashkimi nëpërmjet përthithjes i shoqërisë “BLETA” sh.p.k nga Shoqëria “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k bëhet në kuadrin e riorganizimit të aktivitetit tregtar, përfshirë aktivitetin financiar dhe tregtar të Shoqërisë Përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k.

OBJEKTI i veprimtarisë së shoqërisë Përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k do të përfshijë dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë se Perthithur “BLETA” sh.p.k.

3. AKTIVET DHE PASIVET

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi shoqëria e Perthithur “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k do t'i transferojë shoqërisë Përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k tërësinë e elementeve të aktivitetit dhe pasivitetit sipas bilancit kontabël të vitit që përfundoi më 31.12.2025, duke marrë në konsideratë edhe çdo ndryshim të ndodhur deri në momentin e përthithjes dhe do të kryhet sipas pasqyrave financiare të datës 31.12.2025.

Shoqëria Përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k dhe Shoqëria e Perthithur “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k do të hartojnë pasqyrat financiare të muajit që përfundon më 31.12.2025, të cilat paraqesin vlerën kontabël të aseteve dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur deri më 31.12.2025, dhe do t'i bashkangjiten bilancit të shoqërisë përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k.

Të gjitha marrëdhëniet kontraktuale të lidhura nga shoqëria e përthithur “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k dhe që janë në fuqi në datën e përthithjes, transferohen te shoqëria përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k., e cila merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga këto marrëdhënie kontraktuale.

4. DATA E PËRTHITHJES

Në aspektin juridik, data e përthithjes do të konsiderohet data e pranimit Zyrtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) dhe e lëshimit prej saj të Çertifikatës së Çregjistrimit të Shoqërisë së Perthithur “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k. Efektet financiare dhe të kontabilitetit, përfshirë deklaratimet për Zyrën e Punës dhe për Organet Tatimore do të zbatohen nga data 10.06.2026. Të gjitha operacionet e veprimtarisë pas datës 10.06.2023, do të kryhen nga shoqëria përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k. Pas kësaj date çdo e drejtë apo detyrim, çdo veprim financiar, ekonomik apo administrativ do të kryhet nga Kompania Perthithese “ALBANIAN

SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k dhe do të pasqyrohet në kontabilitet nga shoqëria përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS”sh.p.k.

5. TË DREJTAT DHE DETYRIMET ME PALËT E TRETA DHE ME INSTITUCIONET SHTETËRORE

Pas datës së përthithjes, Shoqëria “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k merr çdo të drejtë e detyrim që ka patur shoqëria e përthithur “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k. në marrëdhëniet me të gjithë personat fizikë apo juridikë si dhe institucionet shtetërore, si organet tatimore vendore dhe qendrore, përfshirë Qendrën Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Regjistrimit të Automjeteve, Zyrën e Punës, etj.

Shoqëria Përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k do të jetë përgjegjëse për ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgjegjësiive financiare, juridike dhe administrative me organet tatimore qendrore dhe vendore deri në çregjistrimin prej tyre të shoqërisë së Përthithur “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k.

6. KAPITALI THEMELTAR

Duke qenë se Kompania Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” sh.p.k ka ortak te shoqërisë te njejtet ortake te shoqërisë që përthithet Shoqëria “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k., ky bashkim me përthithje do të sjell ndryshim ne perqindjet e pjesemarrjeve dhe ndryshim ne Kapitalin Themeltar të shoqërisë përthithëse nga bashkimi i kapitalit te shoqërive, sipas raportit te ekspertit kontabel. .

7. TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA

Ky bashkim me përthithje nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë për ortakët, duke qenë se shoqëria përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS”sh.p.k ka thuasjse te njejtet ortake me shoqërine e përthithur “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k.

8. MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

Punëmarrësit e shoqërisë së përthithur “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k. do të transferohen në shoqërinë përthithëse “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS”sh.p.k, nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të reja të punësimit.

Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, shoqëria e Perthithur “BLETA” sh.p.k. dhe shoqëria Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS”sh.p.k, do të deklarojnë në organet tatimore respektive dhe në Zyrën e Punës largimin nga puna të punonjësve të Shoqërisë së Perthithur “TV KABLLOR SHIJAKU” sh.p.k. dhe marrjen e tyre në punë nga Shoqëria Perthithese “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS”sh.p.k.

9. CAKTIMI I EKSPERTIT KONTABËL

Caktohet "Filito Auditing" Shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar datë 01.02.2008, NUIS Nr. K81401002H, me përfaqësues ligjor Zj. Tatjana Filto (Kotepano), me Licencë Nr.67, date 10.02.2000, të lëshuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA), si Eksperte Kontabël e pavarur për përgatitjen e raportit përfundimtar të bashkimit me përthithje.

Caktimi i ekspertit kontabël nga ana e Administratores së të dyja shoqërive më pas miratohet me emërim edhe nga Asambleja e Ortakëve.

Shoqeria Perthithese

ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS shpk

Administratore

Znj. Juliana Guri




Shoqeria e Perthithur

TV KABLLOR SHIJAKU sh.p.k



Administrator

Z. Shkelqim Berhami



TV KABLLOR
SHIJAKU
0684588530

Hartuar në Tiranë më datë 04.05.2026